



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2152/37 Prot.

Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM

Nr. 254, Datë 30.07.2025

**“PËR CAKTIMIN E ZNJ. ELDA GOXHAJ NË DETYRËN E PROKURORIT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar (në mungesë)
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për caktimin e znj. Elda Goxhaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2152, prot., datë 29.07.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoji Relatorin, z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli), garanton statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Prokurorët emërohen nga Këshilli pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.
2. Në datë 25.07.2025, Këshilli ka emëruar si magjistratë, kandidatët për prokurorë, të diplomuar në vitin akademik 2024-2025 të Shkollës së Magjistraturës, ndër të cilët edhe kandidatja Elda Goxhaj.
3. Me Vendimin nr. 209, datë 25.07.2025, "Për shpalljen e vendeve të lira për caktimin në detyrë të magjistratëve prokurorë, të emëruar në vitin 2025", Këshilli shpalli 26 (njëzetë e gjashtë) vende të lira për caktimin në detyrë të magjistratëve prokurorë, në zyrat e ndryshme të prokurorive ku do të emërohen magjistratët e sapoemëruar.
4. Në nenin 39, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 96/2016, "për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se, *brenda muajit korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magjistrat. Caktimi në pozicion i të emëruarit si magjistrat është parësor dhe bazohet në:*
 - a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, sipas nenit 34 të këtij ligji;
 - b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të emëruarit, sipas pikës 1 të këtij neni, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 3, të nenit 39, të këtij ligji.
5. Bazuar në praktikën e deritanishme të Këshillit, në Marrëveshjen e regjistruar me nr. 2147 prot., datë 29.07.2025, magjistratët e sapoemëruar kanë njoftuar Këshillin për arritjen e dakordësisë ndërmjet tyre për përzgjedhjen e zyrave të prokurorive ku ata do të caktohen në detyrë si prokurorë.
6. Referuar Marrëveshjes në fjalë, magjistratja Elda Goxhaj ka zgjedhur të ushtrojë detyrën si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
7. Përsa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit, caktimin e znj. Elda Goxhaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 39 dhe 41, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 184, germa “b”, 189, pika 1, germa “a” dhe 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Marrëveshjen e magjistratëve regjistruar me nr. 2147 prot., datë 29.07.2025, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë znj. Elda Goxhaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe prokurori Elda Goxhaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 30.07.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla